

*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.11.2023*

08.11.2023

Ora 12:06

RENDI I DITËS

Projektvendim "Shqyrtimi i elementit e të formës dhe përmbajtjes për kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.35 të datës 02.11.2023"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. M. Bardhi
- **Të tjerë:** Përfaqësues i Organizatës Drejtësia Sociale Z.G.Serjani
- **Përfaqësues nga Ministria e Kulturës** Znj.Xh.Xhaferri, znj.F.Islami

Z.L.Braho: Përshëndetje, çelim seancën për shqyrtimin e elementit e formës dhe përmbajtjes për kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.35 të datës 02.11.2023. Ndërmjet kësaj kërke Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është vënë në lëvizje nga Organizata Drejtësia Sociale, e cila ka depozituar një indicie për organizimin e një veprimtarie publike me një institucion publik thotë Komisioneri në pjesën e tij. Veprimtari kjo që nuk është raportuar në faqen e dedikuar për këtë qëllim në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit të Komisionit Rregulator. Në përfundim të kërkesës Komisioneri ka kërkuar që të vendosë gjobë ndaj zonjës Zerina Bruci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike gjobë prej 3 mijë lekë. Gjithashtu i ka bashkëlidhur kërkesës vendimi nr.812 datë 20.10.2023, që është për shqyrtimin administrativ të këtij denoncimi me nr. 409. Gjatë shqyrtimit

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcama*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.11.2023*

administrativ ka qenë palë dhe Ministria e Kulturës, Bashkia e Tiranës, Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, Ansambli Popullor. Janë disa prova nga Face Book që mesa kuptoj janë të Ministres Margariti, është dhe një Erjon që nuk e dëshifrojmë dot. Të pranishëm janë përfaqësues i Organizatës Drejtësia Sociale. Të pranishëm janë përfaqësues të Organizatës Drejtësia Sociale. Ju lutem identifikohuni me emër dhe mbiemër.

Z.G.Serjani: Gentian Serjani, përfaqësues i Organizatës Drejtësia Sociale.

Z.L.Braho: Janë dhe përfaqësuese nga Ministria e Kulturës, ju lutem identifikohuni dhe ju.

Znj. Xh.Xhaferri: Unë jam Xhulia Xhaferi, person kontakti për raportimin e veprimtarisë në Ministrinë e Kulturës.

Znj.F.Islami: Fabiola Islami.

Z.L.Braho:Po ashtu është i pranishëm dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së zoti Ylli Merkaj që përfaqëson dhe KQZ-në. E pranishme është dhe trupa e KAS-it që përbëhet nga 5 anëtarë. Ka ndonjë kërkesë nga palët në lidhje me trupën e KAS-it? Vazhdojmë zoti sekretar i përgjithshëm me pak fjalë na thoni në lidhje me elementet dhe formën e përmbajtjes të kësaj kërkesë.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.11.2023*

Z.Y.Merkaj: Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sanksionim administrativ konstatohet se është në përputhje me nenin 34, 35 të Rregullores së KAS-it dhe neni 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte kërkojmë kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim.

Z.L.Braho:Për palën e interesuar Ministria e Kulturës? Mund të flisni të dyja me rradhë ose njëra, si të doni. Vetëm për elementet të formës dhe përmbajtjes, pra kompetenca.

Znj.Xh.Xhaferi:Pra personi i kontaktit mbi raportimin e veprimtarive me karakter publik dhe për ta vënë në dispozicion pranë KQZ-së, nuk ka marrë raportim nga Ministria e Kulturës për këtë aktivitet të zhvilluar me 3 Maj. Pasi ky aktivitet është zhvilluar nga Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Kulturës, zonja Margariti ka marrë pjesë si e ftuar, kemi dhe ftesën.

Z.E.Lako: Jo për thelbin por elementet e formës dhe përmbajtjes. Mendoni që i plotëson elementet për t'u shqyrtuar nga KAS-i?

Z.L.Braho: Nuk po gjykojmë thelbin sot a ka përgjegjësi sekretari i përgjithshëm apo jo. A duhet ta shqyrtojë KAS-i këtë? Për denoncuesin ju jeni dakord në pjesën e elementit të formës dhe përmbajtjes?

Z.G.Serjani: Plotësisht dakord.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.11.2023*

Z.I.Rusmali: Ju thoni që aktiviteti është zhvilluar me datën 3 Maj dhe është zhvilluar nga Bashkia e Tiranës. Ju a keni informim nëse bashkia ka bërë njoftim publik.

Znj.Xh.Xhaferri: Raportim nuk ka raportuar vetëm një ftesë që është vënë në dispozicion në aktivitetin e organizuar.

Z.G.Serjani: Si provë nuk është administruar gjatë seancës së shqyrtimit. Është pranuar si aktivitet nga ana e ministrisë.

Z.I.Rusmali: Kjo nuk provon gjë.

Znj.Xh.Xhaferri: Pretendon se është ftesa e Bashkisë Tiranë si organizatore e veprimtarisë publike, kemi çuar vetëm një email.

Z.I.Rusmali: Si ka ardhur kjo ka ardhur me postë?

Znj.Xh.Xhaferri: Elektronike ka ardhur.

Z.I.Rusmali: Emailin e kësaj e disponojmë?

Z.L.Braho: Tekstin e emailit që shoqërohet me kërkesën e kemi?

Znj.Xh.Xhaferri: Emaili nuk ka ardhur tek adresa zyrtare që jam unë që e raportoj, por gjithë këtë çështje ma ka raportuar sekretaria e DAP-it. Këtë çështje e kam marrë vesh shumë vonë në fund të gushtit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*



*Procesverbali i zbardhur i Seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.08.11.2023*

Z.L.Braho: Atëherë KAS pasi u këshillua në vend vendosi: Kalimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit nr.35 datë 02.11.2023. Seancën për shqyrtimin administrativ do të caktohet me datën 13 Nëntor ditën e hënë në orën 11:00. Të njoftohen dhe palët e tjera Bashkia Tiranë.

Znj.I.Osmanaj: Emaillet janë çuar në dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës por njëra thonë se paska ikur nga puna..

Z.I.Rusmali: Pse jo personi përgjegjës, ju e keni personin përgjegjës.

Znj.Xh.Xhaferi: I vetmi rast që nuk më ka ardhur.

Znj.I.Osmanaj: Kjo duhet verifikuar se në fillim ka pasur person tjetër kontaktin janë caktuar më vonë si kontakt...

Z.L.Braho: Gjobën pse e ka marrë sekretari i përgjithshëm?

Znj.Xh.Xhaferi: Sepse është veprimtari publike.

Z.L.Braho: Person përgjegjës kush ka qenë?

Znj.I.Osmanaj: Personi përgjegjës është ose sekretari i përgjithshëm ose drejtori përgjegjës dhe pastaj sekretari mund të caktojë një person tjetër që mund të jetë person i administratës.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Ukcemaj*

